



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 165, Datë 15.05.2023

MBI
RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “ENER TRADE” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d”, si dhe nenit 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.05.2023, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1249/6 prot., datë 12.05.2023, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “ENER TRADE” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 227, datë 26.10.2018”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 146, datë 24.04.2023 vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës Nr. 429, Seria F18, të shoqërisë “ENER TRADE” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 227, datë 26.10.2018, për një afat 5-vjeçar.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.04.2023 dhe 26.04.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 04.05.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 1249/5 prot., datë 11.05.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës së rinovimit të licencës.
- Në zbatim të përcaktimeve të Rregullores, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të

dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur); shtojca 1/I; si dhe duhet të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe pagesat e rregullimit në ERE.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “ENER TRADE” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon:
Neni 16, gërma “a”, “b” dhe “c”. **Plotësuar**
Neni 16, pika 7. **Plotësuar**
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën Nr. 429, Seria F18, të shoqërisë “ENER TRADE” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 227, datë 26.10.2018, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 27.10.2023.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “ENER TRADE” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI